



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 73, datë 30. 11. 2022

“PËR MIRATIMIN E BURSAVE PËR NXËNËSIT QË VAZHDOJNË STUDIMET NË SHKOLLAT E MESME PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2022- 2023

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 30. 11. 2022, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 666, datë 10.10.2019, *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave, e të pagesave për nxënësit e arsimit para universitar, në institucionet arsimore publike”*, për vitin shkollor 2022-2023, dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Arsimit , Sportit dhe Rinisë Nr. 6478/40 Prot. datë 01.11.2022, me lëndë “Dërgohet plani i shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë, në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2022 - 2023”, në të cilin vihen në dispozicion të këshillit të bashkisë 6 (gjashtë) bursa

VENDOSI:

1. Dhënie e 6 (gjashtë) bursave sipas listës së mëposhtme të cilët plotësojnë kriteret sipas VKM – së Nr. 666 datë 10. 10. 2019, pika 2.4 shkronja “b”, me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit: Dibër, Bulqizë, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe, Librazhd, Gramsh, Kolonjë, Përmet, Skrapar dhe Tepelenë.

Nr	Emër Mbiemër	Bursa	Klasa	Dega	Fshati	Të ardhurat
01	Keidi Luan Bregu	Plotë	10	Elektroteknik	Nishicë	Nd. Ekonomike
02	Teuta Ardian Zenillari	Plotë	10	Hoteleri-Turizëm	Kalanjas	Nd. Ekonomike
03	Ardi Gazmor Spahiu	Plotë	10	Elektronik	Cerovë	Nd. Ekonomike
04	Besnike Partizan Dervishi	Plotë	10	Shërbim Social Shëndetësor	Zhepë	Nd. Ekonomike
05	Alesjo Partizan Gorçe	Plotë	10	Ndërtim	Potom	-
06	Arjanit Adriatik Pasha	Plotë	10	Mekanik	Visockë	Nd. Ekonomike

2.Nxënësi Marius Kastriot Hasa me vendbanim në Çorovodë, ka qenë i regjistruar në klasën e 11, në shkollën e mesme profesionale “Karl Gega” Tiranë, për vitin shkollor 2021-2022 ka qenë përfitues burse, pasi është shkëputur nga shkolla për arsye emigrimi, në bazë të vendimit nr.666 datë 10.10.2019 pika 3/c e humbet të drejtën e përfitimit të bursës.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Sektori Kulturës, Rinisë dhe Sportit

4.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 10 vota pro , vota kundër - s'ka , vota abstenim - s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI

